



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 25.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 24.10.2024 të parashtruar nga **OE ERK CONSTRUCTION SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufe të Ri” me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1, Autoriteti kontraktues nxjerr:

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim **OE IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.** të dt. 23.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufe të Ri” me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1

Vërtetohet, Njoftimi për kontratë dhe Dosja e Tenderit të publikuara në platformën e prokurimit të datës: 19.09.2024

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Pretendimet e OE ankues

Kerkesa 2. Lista e stafit.

- a) Min Nje inxhinier i ndertimtarise sistemi 5 vjeqar ose (master) drejtimi konstruktiv min 5 vite pervoje pune pas diplomimit, te caktohet si menaxher i projektit.
- b) Min Nje inxhinier i ndertimtarise sistemi 5 vjeqar apo master drejtimi hidroteknik min 5 vite pervoje pune pas diplomimit.

Për pikën a) dhe b) A mundet te jete e mundur me apliku edhe me bachelor, si dhe kriteri me minimum 5 vite te jete kriteri me minimum 3 vite, te behet korigjimi i ketij kriteri sepse është kriter diskriminues sepse jane te pakte operator ekonomik qe kanë inxhinier me 5 vite pervojë pune dhe te ju ipet mundesia edhe operatoreve ekonomik tjere që te marrin pjese ne kete aktivitet te prokurimit.

Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 7 të LPP-së "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatoreve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mire të një ose më shumë operatoreve ekonomik"

Poashtu edhe te kerkesa tjetër e) minimum 2 punetor te certifikuar si armirues është kriter diskriminues sepse jane te pakte operator ekonomik qe kanë armirues te certifikuar dhe bie ndesh me rregullat e PP. Prandaj kerkojme qe te kjo pike te hjeket certifikimi per armirim nga dosja e tenderit dhe te ndryshohet ne vetem armirues.

Kërkojmë nga Autoriteti kontraktues që të hjek kërkesat dhe kriteret diskriminuese duke specifikuar dëshmi –Certifikata të ndryshme në emër të kualitetit pa pasur ndonjë lidhshmëri ndërmjet lëndës së aktivitetit të prokurimit (objektit te kontrates) dhe cilësisë së synuar, kur dihet se përgjegjësinë për projekt e mban menaxheri i projektit (inxhinieret).

Pergjigje per pretendimin tuaj te Pare:

AK ka vendosur kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional duke u bazuar ne rendesine e projektit poashtu ky kriter nuk eshte diskriminues sepse ka mjaftueshem inxhinier me kete lloj profili dhe me kete pervoje qe eshte kerkuar.

Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar

Pergjigje per pretendimin tuaj te Dyte:

Ne kete projekt kemi te bejme me ndertimin e ures ne rrugen Marie Shllaku dhe mbi 70 % e ketij projekti eshte Beton/Arme qe ka te beje per ndertimin e ures prandaj duke u bazuar ne projektin ne fjale dhe paramasen e ketij projekti AK ka kerkuar minimumin e armiruesve te certifikuar.

Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar

Te gjitha shkrimet tuaja jane te pabazuara


AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit